



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTEN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 245/4 Prot

Tiranë, më 5/05/2015

V E N D I M

Nr. 16, datë 5/05/2015

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, Ligjit nr. 8485, datë 12/05/1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", të procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "Alba Contact" sh.p.k.

V Ë R E J S E :

Në zbatim të Urdhrit nr. 58, datë 26/03/2015 është kryer hetim administrativ pranë subjektit kontrollues "Alba Contact" sh.p.k., me objekt: Plotësimi i detyrimit për të njoftuar në zbatim të nenit 21, të Ligjit nr.9887, datë 10/03/2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar.

Kontrolluesi, gjatë ushtrimit të aktivitetit, mbledh, përpunon dhe ruan të dhëna personale për subjektet e të dhënave të cilët kanë lidhje me aktivitetin e tij. Nga hetimi administrativ i ushtruar pranë kontrolluesit dhe provat e administruara rezultoi se "Alba Contact" sh.p.k. nuk e ka përmbushur detyrimin ligjor për të njoftuar pranë Zyrës së Komisionerit (neni 21). Për shkeljen e konstatuar, është mbajtur procesverbali i konstatimit në momentin e ushtrimit të Kontrollit Administrativ. Përfaqësuesi i kontrolluesit "Alba Contact" sh.p.k. nuk ka paraqitur pretendime në procesverbal mbas shkeljeve të konstatuara nga grupi i hetimit administrativ.

Në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar si dhe në zbatim të neneve 93-96 të ligjit nr. 8485, datë 12/05/1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", me shkresën nr. 245/2 prot. dt. 02/04/2015 është njoftuar kontrolluesi "Alba Contact" sh.p.k. për tu paraqitur pranë ambienteve të zyrës së Komisionerit më datë 14/04/2015 ora 10:40, për tu dëgjuar në lidhje me pretendimet e mundshme të tyre.

Kontrolluesi "Alba Contact" sh.p.k. **nuk është paraqitur** në datën dhe orën e përcaktuar dhe njoftuar për seancën dëgjimore, vërtetuar kjo nga verifikimi i bërë në protokollin e institucionit tonë.

Nga verifikimi në sistemin elektronik si dhe në protokollin e brendshëm të autoritetit "Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale", rezulton se kontrolluesi "Alba Contact" sh.p.k. nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim lidhur me plotësimin e detyrimit ligjor të konstatuar në procesverbalin e Kontrollit Administrativ përkatës.

Sipas Ligjit nr.9887, datë 10/03/2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, kontrolluesit kanë përgjegjësinë për përpunimin e të dhënave personale të subjekteve të të

dhënave, e për pasojë, detyrimin e zbatimit e të gjitha kërkesave të këtij ligji, në mënyrë të veçantë, atë të detyrimit që parashikon paragrafi 1 i nenit 21: "...Çdo kontrollues duhet të njoftojë komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligj".

Bazuar në nenin 25/1 të ligjit, kontrolluesi nuk mund të fillojë përpunimin e të dhënave personale pa njoftuar më parë Zyrën e Komisionerit. Në këto kushte, konsiderohet shkelje serioze përpunimi i të dhënave personale, pa njoftuar dhe pa u regjistruar më parë, në Regjistrin Qëndror të subjekteve kontrolluese, të administruar nga Zyra e Komisionerit.

Si përfundim, shkelja e konstatuar gjatë ushtrimit të kontrollit administrativ në kuptim të nenit 39/1 shkronja "d" të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, përbën "**kundërvajtje administrative**" dhe dënohet me gjobë.

Në dhënien e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysh faktin se shkelja e konstatuar është serioze. Ajo cënon të drejtën e subjekteve të të dhënave për tu informuar se kush ia përpunon të dhënat personale, qëllimin e përpunimit të tyre si dhe të drejtën e Komisionerit për të qenë në çdo moment i informuar, si garant i mbrojtjes së ligjit.

PËR KËTO ARSYE :

Në zbatim të neneve 21, 30, 31, 32/1, 39/1/d, 39/2, 40 dhe 41 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar,

V E N D O S A :

1. Dënimin e kontrolluesit "Alba Contact" sh.p.k. me gjobë në vlerën 400.000 (katërqindmijë) lekë.
2. Plotësimin e detyrimit për njoftim pranë Zyrës së Komisionerit brenda 5 (pesë) ditëve nga data e njoftimit të këtij vendimi.
3. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e njoftimit.

Ky vendim u shpall sot në 05/05/2015

